



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 1/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbareme të kreditorit Kompania e Sigurimeve “Eurosig” sh.a, me seli në Prishtinë, Rr.”2 Korriku”, nr.4, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat A.K. me zyre në Prishtinë, kundër debitorit “Trepça” sh.a, me seli në Mitrovicë, 10000, Parku Industrial, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbareme P.nr. 237/2022 e datës 16.12.2022, të lejuar nga Përmbaremi Privat Myjesere Mujku me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 07.11.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Trepça” sh.a, ashtu që Urdhri Përmbareme P.nr. 237/2022 i datës 16.12.2022, i lejuar nga Përmbaremi Privat Myjesere Mujku, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbaremi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania e Sigurimeve “Eurosig” sh.a, me datë 16.12.2022 ka lëshuar urdhrin P.nr. 237/2022, duke lejuar përmbaremin në bazë të dokumentit Faturë nr. 036393 e datës 15.09.2021 me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës së lartcekur t’ia paguaj kreditorit shumën prej 49,995.90 EUR me kamatë ligjore prej 8 % nga data kur pagesa është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbareme.

Debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbareme, me arsyetimin se dokumentet në bazë të të cilave është marr urdhri përmbaremi nuk janë të përshtatshme për përmbaremi. Më tej, ka theksuar se në fatura nuk është cekur koha e përmbushjes së detyrimit, ashtu siç parashihet në nenin 27, par.1 të LPP-së. Nga arsyet e lartcekura i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri përmbareme.

Kreditori në përgjigjen në prapësim ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim me arsyetimin se faturat nuk kanë afat pagese dhe nuk i'u është dhënë afati për pagesë më herët, mirëpo të njëjtat pretendime nuk qëndrojnë sepse polisat në bazë të të cilave janë gjeneruar faturat e të cilat janë pranuar nga debitori janë lëshuar me afat të caktuar pasi që janë bazuar në kontratën publike kornizë e cila ka kaluar procedurat e prokurimit. I ka propozuar Gjykatës që të refuzohet në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit, ndërsa Urdhri Përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimi, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Fatura nr. 036393 e datës 15.09.2021, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje Gjykata gjeti se fatura e lartcekur është pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi dhe vula e debitorit në faturë, dhe e njëjta i është bashkëngjitur propozimit për përmbarim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si e tillë paraqet bazë për lejimin e përmbarimit pasi që është e përshtatshme për përmbarim.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit se koha e përmbushjes së detyrimit është e lidhur ngushtë me barazimin e obligimeve financiare për pagesën e saj mirëpo gjeti se i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së për t'i mbështetur pretendimet e tilla, e rrjedhimisht nuk ekziston asnjëra nga shkaqet e parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr 1/23, datë 07.11.2023

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.